

**VENDIM**  
**Nr.1002, datë 10.12.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ZAPOD TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zapod të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zapod të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.37, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zapod të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zapod për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Zapod Kukës

Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                                                                                                | Lloji i transferimit |
|--------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 1-5                                              | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore                                                                      | Në pronësi           |
| 6-7, 10-11, 13-14, 16-17, 19-21, 23-25, 27-28    | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)                       | Në përdorim          |
| 8-9, 12, 15, 18, 22, 26, 29                      | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta) | Në pronësi           |
| 30                                               | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën shëndetit publik                                                   | Në pronësi           |
| 34-35                                            | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve                                           | Në pronësi           |
| 70-74                                            | Infrastrukturë (rrugë vendore)                                                                                              | Në pronësi           |
| 85-109                                           | Varreza publike                                                                                                             | Në pronësi           |